

Kushtet e përgjithshme të përdorimit të web faqes së JUB-it

1. Hyrje

Për qëllimet e këtij njoftimi, web faqe është termi që përfshinë të gjitha web faqet e internetit në www.jub.si

2. Përmbajtja e web faqes

E gjithë përmbajtja që është në web faqe është e një natyre informuese dhe shërben kryesisht për informim. JUB është i përkushtuar të bëjë gjithçka që është në fuqinë e tij, që informatat të jenë të vërteta, të besueshme dhe cilësore. Megjithatë, ai nuk është përgjegjës për asnjë gabim të shtypjes dhe për vonesat dhe mangësitë në futjen e të dhënave të azhuruara.

3. Mbrojtja e të drejtave të autorit

Kjo web faqe është pronë ekskluzive e JUB-it dhe çdo keqpërdorim i të dhënave, imazheve, tekstit, është i ndaluar. Çdo kopjim, shpërndarje ose përdorim tjetër i të gjitha të dhënave të mësipërme pa njohuri paraprake dhe leje të JUB, është e ndaluar.

4. Mbrojtja e të dhënave

Herën e parë që vizitoni web faqen, "cookie" ruhet në kompjuterin tuaj, të cilin gjithashtu, në Settings mund të aktivizoni karakteristikat e nevojshme për të parandaluar ruajtjen. Janë cookies që kujdesen për komunikim më të mirë me web faqe dhe përmes të cilave për shembull, një faqe në internet mund të menaxhojë karakteristikat tuaja personale. Është e rëndësishme të dihet se nuk ka asnjë mënyrë që ne t'i marrim të dhënat tuaja personale nga kompjuteri përveç atyre që janë në dispozicion të publikut (lloji i shfletuesit, lloji i sistemit operativ, etj.). Informata që ju vendosni në web faqe na dërgohet në internet në formë të pambrojtur, në formë elektronike dhe mund të vihet në dispozicion të palëve të treta. Për të mbrojtur informatat tuajat mos futni identitetin dhe privatësinë që nuk dëshironi të zbulohet.

5. Links/Lidhjet e jashtme

Pjesë të web faqes sonë janë të lidhura me faqe të tjera, të cilat nuk janë pjesë e web faqes sonë. Për karakteristikat e web faqeve të tjera ne nuk mbajmë përgjegjësi.

6. Ndryshimi i kushteve

JUB rezervon të drejtën të ndryshojë kushtet e përgjithshme pa njoftim paraprak. Ndryshimet hyjnë në fuqi sapo të publikohen. Për shkak të këtyre të drejtave, ju jeni të lutur që në çdo vizitë të lexoni me kujdes termat dhe kushtet e përdorimit të faqes sonë të internetit.

7. Gjykata kompetente

Për shpjegim dhe çdo pyetje ligjore në lidhje me përdorimin e materialeve të postuara në këto web faqe në internet, web faqet drejtohen ekskluzivisht nga ligji sloven. Për pretendimet dhe mosmarrëveshjet në lidhje me përdorimin e materialeve të përmendura është gjykata kompetente në Lubjanë.

8. Rregullat e përpunimit të të dhënave personale të JUB d.o.o.

a. Qëllimi dhe menaxhimi

Qëllimi i rregullave për përpunimin e të dhënave personale është t'ju ofrojnë kontroll dhe informacion, dhe të ju tregojmë se çfarë informacioni personal mbledhim, pse i mbledhim dhe si i përdorim.

Kontrolluesi i të dhënave personale është kompania JUB d.o.o., Dol pri Ljubljani 28, 1262 Dol pri Ljubljani, e-mail: enovice@jub.si.

Kontrolluesi i të dhënave personale mund të përpunojë të dhënat personale, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave: (1) nëse përpunimi është i nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, (3) nëse përpunimi është i nevojshëm për të qenë në përputhje me statutin për detyrimet e ndërmarrjes, (3) ose, në rastin e përpunimit në kuadër të bashkëpunimit tonë, vullnetarisht e pranoni këtë.

b. Qëllimi dhe llojet e përzgjedhjes së të dhënave personale

JUB përmes web faqes përzgjedhë informatat personale:

i) E-risitë

Nëse përmes web faqes sonë e keni porositur e-risitë, atëherë ne duhet të marrim e-mail adresën tuaj për t'ju dërguar e-risitë.

ii) Pyetje apo kërkesa

Nëse në webfaqen tonë keni bërë pyetje apo ndonjë kërkesë, të dhënat e juaja personale përdoren me qëllim që t'ju përgjigjemi, apo t'ju dërgojmë ofertën. Në mënyrë që komunikimi të jetë më i lehtë, ju lutemi ta shënoni saktë emrin, mbiemrin, e-mail adresën gjegjësisht numrin e telefonit, në këtë mënyrë me lehtësi do të mund t'ju informojmë detajisht për pyetjen/kërkesën e juaj.

iii) Porosia në studion e ngjyrave

Nëse në webfaqen tonë keni porositur në studionin e ngjyrave, informatat e juaja personale përdoren në mënyrë që ta realizojmë dizajnimin e fasadës me ngjyra. Përpos emrit dhe mbiemrit tuaj, ju lutemi të shkruani edhe e-mail adresën tuaj dhe numrin e telefonit.

iv) Shitja përmes internetit

Nëse në web faqen tonë keni porositur ndonjë produkt, të dhënat e juaja personale do të përdoren për shkak të dërgimit të mallit të porositur. Përpos emrit dhe mbiemrit tuaj, në mënyrë që të kemi komunikim më të lehtë, ju lutemi të shkruani edhe e-mail adresën tuaj dhe numrin e telefonit.

v) Lojrat shpërblyese

Nëse merrni pjesë në ndonjërin nga lojrat tona shpërblyese, të dhënat e juaja personale, të cilat i keni shkruar në kuponin e dërguar, do të përdoren për qëllim të lojës shpërblyese. JUB përdorë të dhënat personale individuale vetëm për qëllim të shpërndarjes së shpërblimeve, sikurse edhe për pagimin e tatimit varësisht nga vlera e dhuratës.

Të dhënat e juaja personale mund të përdoren edhe për qëllime të tjera vetëm nëse ju keni dhënë pëlqimin. Pëlqim nënkupton cilindo vullnet tuajin të qartë, të shprehur me deklaratë pa mëdyshje që

shpreh pëlqimin tuaj për përpunimin e të dhënave personale për një qëllim specifik. Ju mund të jepni deklaratën tuaj (me shkrim ose me gojë) ose një pohim tjetër të qartë me veprim. Në rastin e përdorimit të web faqes së JUB-it, p.sh. pëlqimi konsiderohet kur jeni në një faqe në internet me një klikim në një dritare të zbrazët, konfirmoni që lejoni përpunimin e të dhënave personale për një qëllim specifik (p.sh. për porosi të lajmet/risive elektronike).

Nëse jeni më të rinjë se 15 vjeç, aprovimi i juaj me të dhënat e juaja personale është i pavlefshëm. Në këtë rast njëri nga prindërit ose kujdestarët duhet të japë pëlqimin për përpunimin e të dhënave tuaja personale.

c. Përpunimi i të dhënave personale

Nëse jeni pajtuar me këtë, të gjitha të dhënat tuaja personale mund të përdoren gjithashtu për marketing direkt, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale (Akti mbi mbrojtjen e të dhënave personale) dhe akteve të tjera ligjore detyruese në nivelin shtetëror dhe në nivel të Unionit Evropian (rregullorja e përgjithshme e mbrojtjes së të dhënave). Marketingu direkt kryhet para së gjithash:

- Për qëllim të informimit të vazhdueshëm me risitë, për dergimin e ofertave, materialit reklamues, revistave dhe ftesave për evente;
- Të informojë për lojrat shpërblyese të organizuara nga JUB ose të organizuara nga një tjetër person juridik që organizon një lojë shpërblyese në bashkëpunim me JUBin;
- Krijimin e ofertave të personalizuar bazuar në preferencat dhe interes tuaja të shprehura;
- Marketingu direkt mund të kryhet përmes të gjitha kanaleve të komunikimit: përmes e-mailave, SMS-ve dhe MMS-ve, telefon (fiks dhe celular), facebook dhe rrjete të tjera sociale. Ne do t'ju informojmë vetëm përmes kanaleve të komunikimit për të cilat ju keni dhënë pëlqimin.

Ne gjithashtu përpunojmë të dhënat personale për qëllime të hulumtimeve të ndryshme të brendshme ose analizat përkatëse duke përcaktuar suksesin e një fushate të marketingut. Ne përdorim rezultatet e

këtij hulumtimi për të përmirësuar proceset tona, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në drejtim të performancës më të mirë.

d. Periudha e ruajtjes së të dhënave

Periudha e mbajtjes së të dhënave përcaktohet nga kategoria e të dhënave individuale. Të dhënat personale, të marra për qëllimet e lidhjes dhe zbatimit të marrëdhënieve kontraktuale, ne jemi tatimpagues ligjor, që paguan tatimin mbi vlerën e shtuar, e kërkuar për t'u ruajtur për 10 vjet. Të dhënat tjera personale ruhen derisa të përmbushet qëllimi për të cilin janë mbledhur, ose maksimum 5 vjet pas përfundimit të marrëdhënies së biznesit me individin. Të dhënat personale, të përpunuara në bazë të pëlqimit tuaj, ruhen maksimum 1 vit nga revokimi i pëlqimit.

Pas skadimit të periudhës së mbajtjes së të dhënave, ato do të fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose anonimizohen, përveç nëse me ligj nuk parashikohet ndryshe për secilin lloj të të dhënave.

e) Kërkesa për ndërprerjen e përdorimit të të dhënave personale

Nëse përpunojmë të dhënat tuaja personale me pëlqimin tuaj (p.sh. përpunimi për marketing direkt), ju mund të revokoni pëlqimin tuaj me shkrim në çdo kohë me e-mail në adresën tonë JUB d.o.o., Dol pri Ljubljani 28, 1262 Dol pri Ljubljani, ose duke njoftuar enovice@jub.si, gjithashtu me mundësi të çregjistrimit në çdo e-mail që ne ju dërgojmë.

Anulimi i juaj nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit, e cila në bazë të pëlqimit tuaj kryhet derisa të revokohet.

f) Të drejtat e individëve

Nëse JUB përpunon të dhënat tuaja personale, ju keni të drejtat e mëposhtme:

l) E drejta për korrigjim: ju mund të kërkonit që t'i shtoni ose korrigjoni të dhënat tuaja personale nëse ato janë jo të plota ose të pasakta.

II) E drejta e fshirjes: Ju keni të drejtë të fshini të dhënat tuaja personale kur zbatohet një nga arsyet e mëposhtme: (a) të dhënat personale nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur ose përpunuar ndryshe; (b) kur anuloni pëlqimin për të cilin bëhet përpunimi dhe kur nuk ka ndonjë bazë tjetër ligjore për përpunimin; (c) kur ju kundërshtoni përpunimin dhe nuk ka ndonjë arsye mbizotëruese të ligjshme për përpunimin e tyre; (d) të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme.

III) E drejta e qasjes: Ju gjithmonë keni të drejtë të dini nëse të dhënat personale janë duke u përpunuar në lidhje me ju edhe kur kjo është rastësi, qasjen në të dhënat personale dhe informacionin e mëposhtëm: (a) qëllimet e përpunimit; (b) llojet e të dhënave personale në fjalë; (c) përdoruesit ose kategoritë e përdoruesve të cilëve u janë dhënë ose do t'u zbulohen të dhëna personale; (d) periudhën e parashikuar të mbajtjes së të dhënave personale ose, nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar atë periudhë; (e) kur të dhënat personale nuk janë mbledhur nga ju, të gjitha informacionet në dispozicion në lidhje me burimin e tyre.

IV) E drejta për të kufizuar përpunimin: ju mund të kërkontë kufizime në përpunimin e të dhënave tuaja personale, veçanërisht nëse kundërshtoni saktësinë e tyre - për një periudhë që na lejon të verifikojmë saktësinë e të dhënave tuaja personale; nëse përpunimi është i paligjshëm, ju kundërshtoni fshirjen e të dhënave personale; nëse periudha e ruajtjes së të dhënave ka skaduar dhe ju nevojitet për të zbatuar pretendimet ligjore; nëse keni bërë një kundërshtim në lidhje me përpunimin bazuar në interesat legjitime të JUB-it, derisa të jetë verifikuar që arsyet tona legjitime mbizotërojnë arsyet tuaja.

V) E drejta për transmetueshmëri të të dhënave: Keni të drejtë të merrni të dhënat tuaja personale të siguruar për ne në një formë të strukturuar të përdorur zakonisht dhe të lexueshme nga makina, dhe të drejtën për t'i kaluar këto të dhëna tek një kontrollues tjetër kur përpunimi bazohet në pëlqimin tuaj ose përpunimi kryhet me mjete të automatizuara. Me kërkesën tuaj, kur është teknikisht e mundur, të dhënat personale mund të transferohen drejtpërdrejt te një operator tjetër.

VI) E drejta për të kundërshtuar: Kur ne përpunojmë të dhënat tuaja në bazë të një interesi të ligjshëm për qëllime marketingu, përfshirë profilizimin, ju mund të kundërshtoni përpunimin e tillë në çdo kohë. Ju keni të drejtë të kërkonti që të përpunojmë vetëm të dhëna personale që janë rreptësisht të nevojshme për zbatimin e metodave të përpunimit të të dhënave personale me të cilat individi ka rënë dakord ose që t'i përpunojmë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi.

VII) E drejta për të paraqitur ankesë te Komisioneri i Informacionit: Nëse nuk vendosim për kërkesën tuaj brenda afatit ligjor ose nuk e refuzojmë kërkesën tuaj, ju keni mundësinë e paraqitjes së një ankese te Komisioneri i Informacionit i Republikës së Sllovenisë, Zaloška cesta 59 , 1000 Lubjanë, Slloveni.

g) Dispozitat përfundimtare

Duke hyrë në faqen e internetit, ju pranoni, që jeni në dijeni dhe keni rënë dakord për të gjithë kushtet e mësipërme.

Çdo gjë që nuk rregullohet nga këto rregulla, i nënshtrohet ligjit në fuqi.

Këto rregulla hyjnë në fuqi më 8.5.2018.

JUB d.o.o.